

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA
KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A- 24/13

Prishtinë,
28 maj 2015

Në çështjen juridike të:

M. M. P.

Adresa ...

Tivar, Mali i zi

duke vepruar ne emrin e S. I. ose trashëgimtarëve ligjor të saj

Pala ankuese

kundër.

N. K.

Adresa ...

Pejë

Pala Përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët, Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e bashkuara nën numrin e lëndës GSK-KPA-A-24/13, kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) KPPC/D/A/149/2012 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA17662, KPA28982, KPA28983, KPA28984, KPA28985, KPA28986, KPA28989, KPA92434), të datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 28 maj 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohen si të pabazuara ankesat e M. P., të bashkuara në lëndën nr.GSK-KPA-A-24/13, kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/149/2012, i datës 19 prill 2012.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/149/2012 i datës 19 prill 2012, për sa i takon kërkesave me numrat KPA17662, KPA28982, KPA28983, KPA28984, KPA28985, KPA28986, KPA28989 dhe KPA92434.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datën 18 dhjetor 2006, M. P. (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës ose përfaqësuesi i pretenduar) kishte paraqitur disa kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke pretenduar konfirmimin e të drejtës së tij në ngastrat e tokës të listuara si më poshtë (në tekstin e mëtejme të gjitha: prona e kërkuar).
2. M. P. ka theksuar se babai i tij M. P. kishte qenë pronar i pronës së kërkuar, dhe që më pas posedimin e së cilës e kishte humbur me datë 12 qershor 1999 si rezultat i rrethanave në Kosovë në 1998/1999.
3. Ai më tutje ka theksuar se nuk dinë se kush ishte në shfrytëzim të pronës së kërkuar në atë kohë.
4. Të dhënat e pronës së kërkuar, që të gjitha të evidencuara në Kopjen e Planit nr. 6 të Komunës së Pejës, Komuna Kadastrale Gorazhdec, të lëshuar më 26 prill 1972, janë me sa vijon:

Numri i ankesës	Numri i lëndës në AKP	Nr. i ngastrës dhe sipërfaqja	Vendi	Fshati	Komuna	Vërejtje(s)
GSK-KPA-A-24/2013	KPA 17662	(a) 499/1, (b) 499/2, (c)499/3 dhe (d) 499/4, sipërfaqja e përgjithshme është 4 ha 40 ari 79m ² *	Bezdavnicë	Gorazhdec	Pejë	
GSK-KPA-A-25/2013	KPA 28982	499/1, me sipërfaqe prej 0 ha 5ari 0m ²	Bezdavnicë	Gorazhdec	Pejë	
GSK-KPA-A-26/2013	KPA 28983	499/1 me sipërfaqe prej 3 ha 7ari 77m ²	Bezdavnicë	Gorazhdevac	Pejë	Në formularin e kërkesës theksohet se ngastra e kërkuar është vetëm ngastra 499/1 me sipërfaqe prej 3 ha 7 ari 77m ² , ndërsa

						vendimi i KKPK-së është për të gjitha ngastrat: 499/1, 499/2, 499/3, & 499/4 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4 ha 40 ari 79 m ² (njëjtë si në lëndën 24/2013)
GSK-KPA-A-27/2013	KPA 28984	499/2, me sipërfaqe prej 0 ha 24 ari 14 m ²	Bezdanica	Gorazhdec	Pejë	
GSK-KPA-A-28/2013	KPA 28985	499/3, me sipërfaqe prej 0 ha 15 ari 9 m ²	Bezdanica	Goraždevac	Pejë	
GSK-KPA-A-29/2013	KPA 28986	499/4 me sipërfaqe prej 0 ha 88 ari 1m ²	Bezdanica	Gorazhdec	Pejë	
GSK-KPA-A-30/2013	KPA 28989	499/1, me sipërfaqe prej 0 ha 5 ari 0 m ²	Bezdanica	Goraždevac	Pejë	Ngastra e njëjtë si në lëndën 24/13 dhe 25/2013
GSK-KPA-A-31/2013	KPA 92434	499/1, 499/2, 499/3 dhe 499/4, sipërfaqja e përgjithshme është 4 ha 40 ari 79m ²	Bezdanica	Gorazhdec	Pejë	Ngastrat e njëjta si në lëndën 24/2013

* **a) 499/1** (objekt shtëpie në sipërfaqe prej 78 m², oborr në sipërfaqe prej 5 ari dhe tokë e punueshme e klasës së 5-të në sipërfaqe prej 3 ha 07 ari 77 m²), **(b) 499/2** (pemishte e klasës së 3-të në sipërfaqe prej 24 ari 14 m²), **(c) 499/3** (kullosë e klasës së 3-të me sipërfaqe prej 15 ari 09 m²) dhe **(d) 499/4** (kullosë e klasës së 3-të në sipërfaqe prej 88 ari 01 m²) **me sipërfaqe të përgjithshme prej 4 ha 40 ari 79 m²**. Lënda e të gjitha kërkesave është e njëjta pronë (ngastrat e përmendura më lartë).

5. Për të mbështetur kërkesat e tij, përfaqësuesi i pretenduar ka dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:

- Kopjen e Planit nr. 6 të lëshuar nga Komuna Kadastrale e Gorazhdecit, Komuna e Pejës më 26 prill 1972, që paraqet se prona e kërkuar ishte regjistruar në emrin e I. (P.) S.; (verifikimi pozitiv)
- Autorizimin OV.br/VR.nr. 538/1972 të datës 28 prill 1972, që paraqet se halla e ndërës e paraqitësit të kërkesës e kishte autorizuar atë për të lidhur kontratë mbi ndarjen dhe shpërbërjen e bashkësisë familjare me vëllain e saj M. P. (i ati i paraqitësit të kërkesës); (verifikimi pozitiv).
- Skicën lidhur me pronën e kërkuar.

- Certifikatën e vdekjes të hallës së paraqitësit të kërkesës, I. S., e lëshuar me datë 23 tetor 2007 nga Komuna e Pejës në Kragujevcit, Republika e Serbisë (prima facie e verifikuar si autentike;
 - Certifikatën e vdekjes të babait të paraqitësit të kërkesës M. P., të lëshuar nga Komuna e Pejës në Kragujevc, Republika e Serbisë (verifikimi pozitiv)
 - Letrën njoftuese pa datë, ku theksohet se ekziston një gabim në Certifikatën e Vdekjes të I. (P.) S. (Sipas përfaqësuesit të pretenduar, data e vdekjes është vendosur gabimisht si 10 mars 1972 ndërsa duhet të jetë 10 maj 1972);
 - Kartelën identifikuese të refugjatit të paraqitësit të kërkesës nr. 10001314 të lëshuar më 28 qershor 2003 (verifikimi pozitiv).
6. AKP organizoi disa herë njoftimin e kërkesave. Në vitin 2010, 2011 dhe 2012 ekipi për kryerjen e njoftimit kishte vendosur shenjat ku theksohej se prona e kërkuar është subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhet të paraqesin njoftimin mbi pjesëmarrjen brenda 30 ditëve. Gjatë kryerjes së procesit të njoftimit në vitin 2011, N. K. ishte i pranishëm dhe ai kishte nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes. Më vonë, të gjitha njoftimet ishin kontrolluar bazuar në të dhënat kadastrale, koordinatat e GPS-it dhe ortofoto dhe ishte konstatuar se ato kishin qenë të sakta.
7. Sipas raportit të verifikimit të datës 4 korrik 2008 Njësia Verifikuese e AKP-së kishte gjetur *ex officio* Fletën Poseduese nr. 128 të lëshuar me datë 30 janar 2007 nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Pejës, i cili paraqet se prona e kërkuar ishte evidencuar në emër të Bartësit të së Drejtës Pronësore “I. Š.”. Raporti i njëjtë sqaron se Autorizimi OV.br/VR.nr 538/72 i datës 28 prill 1972 i verifikuar me datë 28 tetor 1972, i dorëzuar nga paraqitësi i kërkesës është verifikuar pozitivisht.
8. Më 19 prill 2012, KKPK në vendimin e saj KPCC/D/A/149/2012 kishte hedhur poshtë kërkesat e paraqitësit të kërkesës të evidencuara me numrat KPA17662, KPA28982, KPA28983, KPA28984, KPA28985 dhe KPA28986, pasi që autorizimi i dorëzuar nga paraqitësi i kërkesës dhe që siç supozohej ishte lëshuar nga halla e tij për të bartur pronat e kërkuara në emër të babait të tij, nuk ishte i vlefshëm. Vendimi sqaron se *“autorizimi nuk duket të jetë i vlefshëm pasi që sipas certifikatës së vdekjes së hallës së paraqitësit të kërkesës, halla kishte ndërruar jetë në muajin mars 1972, pra ajo nuk kishte mundur të lëshonte asnjë autorizim në muajin prill 1972; gjithashtu, paraqitësi i kërkesës ishte fëmijë në kohën kur siç pretendohet ishte lëshuar autorizimi”*.

9. KKPK, në një vendim tjetër të lëshuar në të njëjtën datë, 19 prill 2012, KPCC/D/R/152/2012, kishte hedhur poshtë kërkesën nr. KPA28989 me të njëjtin arsyetim siç paraqitet në vendimin e KKPK-së (KPCC/D/A/149/2012) se paraqitësi i kërkesës e kishte paraqitur kërkesën në emër të hallës së tij në mungesë të një autorizimi të vlefshëm ndërsa e kishte refuzuar kërkesën nr. 92434 në mungesë të ndonjë të drejte të dëshmuar pronësore të babait të tij.
10. Vendimet i ish-in dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 2 dhjetor 2012. Më 3 dhjetor 2012, vendimet i ish-in dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë. Më 18 dhjetor 2012, paraqitësi i kërkesës (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) kishte paraqitur ankesat në Gjykatën Supreme. Ankesat ish-in regjistruar me numrin e lëndës GSK-KPA-A-24-25-26-27-28-29-30 dhe 31, respektivisht.
11. Përfaqësuesi i pretenduar kishte dorëzuar me ankesën e tij *inter alia* katër “Autorizime”. Sipas këtyre autorizimeve S. M. J., S. S., S. B. dhe B. N. më 20 korrik 2009 e kishin autorizuar përfaqësuesin e pretenduar të marrë pronën e kërkuar të emës së tyre të ndjerë I. S., mbiemri i vajzërisë P., ‘*në dispozicion të tijin*. Për më tepër ata kishin autorizuar atë ‘*të shes, dhujoj, tjetërsoj*’ pronën e kërkuar ‘*në ndonjë mënyrë tjetër*’ dhe ‘*të nënshkruaj kontratën*’ në emër të tyre ‘*në gjykatën kompetente dhe gjithashtu të nënshkruaj dokumentet e tjera të nevojshme për regjistrimin e ndërrimit të pronësisë në librat e regjistrimit të tokës*’.
12. Gjykata Supreme, në aktvendimin e saj të datës 27 maj 2013, vendosi që të bashkoj këto tetë lëndë nën numrin GSK-KPA-A- 24/13 për shkak të lidhshmërisë mes tyre.
13. Më 28 maj 2013, Gjykata Supreme gjithashtu lëshoi një urdhër gjykate për përfaqësuesin e pretenduar ku kërkonte nga ai:
- a. Të paraqes vendimin mbi trashëgiminë, i cili do të vërtetonte kush janë trashëgimtarët e ligjshëm të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore I. S., e cila kishte vdekur në vitin 1972 (pala ankuese pretendon se S. J., S. S., S. B. dhe B. N. janë trashëgimtarët por në dosje nuk ka asnjë dëshmi për këtë; nuk ka asnjë vendim mbi trashëgiminë apo ndonjë dokument tjetër që dëshmon se këta persona janë trashëgimtarët e bartësit të së drejtës pronësore) dhe
 - b. T’i shpjegoj Gjykatës se në çfarë mënyre humbja e pronës së kërkuar ndërlidhet drejtpërdrejtë apo rezulton nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 (neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e

ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079), kur kihet parasysh se bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore kishte vdekur në vitin 1972 dhe se nuk ekzistonin të dhëna kush ka qenë duke i shfrytëzuar pronat pas vdekjes së saj.

14. Në përgjigje ndaj urdhrorit të gjykatës përfaqësuesi i pretenduar, thekson në letrën e datës 30 korrik 2013 se procedura e trashëgimisë nuk është iniciuar pas vdekjes së hallës së tij I. S. Prandaj, është e pamundur të sigurohet vendimi i trashëgimisë. Ai gjithashtu i referohet autorizimeve të lëshuara nga fëmijët e hallës dhe ka bashkangjitur certifikatat e lindjes të këtyre fëmijëve si dëshmi të trashëgimtarëve të ligjshëm. Ai gjithashtu thekson se babai i tij, ai dhe familja e tij kishin shfrytëzuar pronën e kërkuar deri në shpërthimin e konfliktit.

Pretendimet e palëve

15. Përfaqësuesi i pretenduar, deklaron se është e pavërtetë se autorizimi i vërtetuar mungon dhe se ai nuk është i autorizuar të paraqesë kërkesën në emër të bartësit të së drejtës pronësore ose trashëgimtarëve të tij. Ai për më tepër i kundërshton vendimet e KKKP-së duke theksuar se ai kishte autorizimin e datës 28 prill 1972 nga halla e tij e ndjerë S. I. dhe autorizimin nga fëmijët e hallës së tij të ndjerë dhe se ai mund të shes pronat, të jap apo tjetërsoj ato në forma të tjera. Ai i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës të anuloj vendimin e KKKP-së dhe të kthejë lëndën në rigjykim.
16. Pala përgjegjëse në ankesë ka theksuar se pronat e kërkuara i takojnë paraardhësve të tij. Ai ka theksuar se në vitin 1932 Qeveria i kishte marrë këtë pronë pa asnjë kompensim dhe ia kishte dhënë ato familjes P. Ai ka shtuar se “ata” kishin Tapinë (dokument Otoman) si provë por ajo ishte djegur gjatë luftës në vitin 1999. Ai gjithashtu ka theksuar se ata nuk i kishin uzurpuar këtë pronë por vetëm ishin duke e shfrytëzuar barin për lopët e tij. Gjithashtu, ai ka theksuar se ai është i interesuar të kontaktoj përfaqësuesin e pretenduar për të blerë pronat, pasi që këto ishin në kufi me pronën e tij dhe afër shtëpisë së tij.

Arsyetimi ligjor:

Meritat e ankesës

17. Sipas deklaratave të përfaqësuesit të pretenduar në ankesë, ai ushtron këtë ankesë në cilësinë e përfaqësuesit të bartësit të së drejtës pronësore (të pretenduar) në pronën e kërkuar. Ai thekson se halla e tij ose fëmijët e saj janë bartës(it) e së drejtës pronësore. Pra,

ai nuk thekson edhe më tutje se e përfaqëson babain e tij. Prandaj, Gjykata Supreme nuk mund të përgjigjet në këto pretendime.

18. Për sa i takon asaj që ai mendon që të ushtroj ankesë si përfaqësues i hallës së tij (të ndjerë) ose fëmijëve të saj, Gjykata Supreme ankesën e tij e nënkupton si mënyrë e sigurimit të vendimit në pyetjen nëse ai ka të drejtë të përfaqësimin të bartësit të së drejtës pronësore (të pretenduar) dhe paraqitjes së kërkesave para KKPK-ës.
19. KKPK-ja i përgjigjet këtyre pyetjeve negativisht. Prandaj, Gjykata Supreme do të vendos tani nëse KKPK-ja i është përgjigjur këtyre pyetjeve në mënyrë të drejtë dhe arsyeton si vijon.
20. Për sa i takon deklaramin të përfaqësuesit të pretenduar se ai ende përfaqëson hallan e tij ky pretendim duhet të lihet anash. Sipas nenit 12.2 të rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji UNMIK 2006/50), për atë që është i rëndësishëm, dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Kontestimore duhet të aplikohen përshtatshëm në këtë procedurë. Sipas nenit 95 të Ligjit të Procedurës Kontestimore nëse personi vdes, autorizimi i cili është lëshuar nga ai person bëhet i pa efekt. Prandaj, edhe pse Gjykata Supreme duhet të ndjekë përfaqësuesin e pretenduar në pretendimet e tij se hala e tij i kishte dhënë ndonjë të drejtë atij për ta përfaqësuar atë dhe se autorizimi kishte përfshirë edhe paraqitjen e kërkesës para AKP-ës, ky autorizim nuk ka efekt të mëtutjeshëm. Prandaj, autorizimi nuk mund të shërbejë për të si bazë për përfaqësimin e bartëses së të drejtës pronësore (të pretenduar) para KKPK-ës.
21. Për sa i takon pretendimit të përfaqësuesit të pretenduar se ai dëshiron të përfaqësojë fëmijët e hallës së tij, ai gjithashtu nuk ka ofruar dëshmi të nevojshme. Para së gjithash ai nuk ka ofruar dëshmi për pretendimin se të katërt nga ta ose ndonjëri prej tyre kishte trashëguar pronën e kërkuar. As edhe në përgjigjen në urdhër, ai nuk i ka ofruar këto lloje dëshmish. Por, edhe nëse Gjykata Supreme do të pranonte pretendimin e tij – të mbështetur në certifikatat e lindjes – se këta të katërt janë fëmijët e hallës së tij dhe se ata kishin trashëguar pronën e kërkuar, edhe atëherë autorizimi nuk do të mjaftonte t'i përfaqësonte ata në procedurën para KKPK-ës. Sipas fjalëve në autorizimet e dhëna, përfaqësuesi i pretenduar është i autorizuar vetëm që pronën e kërkuar ta disponojë, ta shes, ose ta tjetërsojë pronën e

kërkuar ose të nënshkruaj kontratën për pronën e kërkuar dhe që të nënshkruaj ndonjë dokument të nevojshëm për regjistrimin ose ndryshimin e pronësisë në librat e tokës. Sipas fjalëve ata nuk e autorizojnë atë që t'i përfaqësoj ata në provëdurën gjyqësore sikur kjo para KKPK-ës, për shkak se kjo procedurë ka të bëjë me të drejtën e pronësisë së bartëses së të drejtës pronësore (të pretenduar).

22. Për shkak të gjithëpërfshirjes, Gjykata Supreme vëren gjithashtu se përfaqësuesi i pretenduar nuk mund të përfaqësoj gjithashtu bartësen e së drejtës pronësore si anëtar i familjes së ngushtë ashtu siç është theksuar në nenin 1 dhe 5.2 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2007/5 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Aneksi I i Ligjit UNMIK 2006/50). Sipas nenit 5.2 të Aneksit I të Ligjit UNMIK 2006/50 në rastin kur personi fizik nuk mund të paraqes ankesë para KKPK-ës, kërkesë mund të paraqitet nga anëtari i familjes së ngushtë, duke nënkuptuar gruan, fëmijët dhe personat e tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t'i mbështesë sipas ligjit të aplikueshëm, ose personat që janë të obliguar të mbështesin bartësin e së drejtës pronësore, sipas ligjit të aplikueshëm. Përfaqësuesi i pretenduar nuk hyn në këtë definicionin e anëtarit të familjes së ngushtë ashtu siç është përcaktuar në ligj. Para së gjithash, pronari i regjistruar i pronës së kërkuar është halla e tij e cila veq kishte vdekur në vitin 1972, kur paraqitësi i kërkesës ishte fëmijë. Nuk ekziston më mundësia që paraqitësi i kërkesës të mbështesë financiarisht hallën e tij dhe as ajo atë. Ai gjithashtu nuk ka argumentuar, dhe se nuk ka kurfarë indikacioni në shkresat e lëndës që ai dhe fëmijët e hallës së tij të vdekur mund të përfshihen në definicionin e anëtarit të familjes së ngushtë.

Konkludimi

23. Gjykata Supreme përfundon se KKPK-ja ka vendosur drejtë që M. P. nuk ka argumentuar se ai mund të përfaqësoj bartësen e së drejtës pronësore (të pretenduar) në procedurën para KKPKës. Rrjedhimisht, sipas nenit 13.3 të Ligjit UNMIK 2006/50 Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Willem Brouwer, Gjyqtare e EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it